



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	20.10.2025
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkryetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Shtator

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 01.10.2025 deri me 30.10.2025

Lipjan 2025

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Gjatë muajit shtator, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka vazhduar me realizimin e disa aktiviteteve dhe projekteve të planifikuara për këtë periudhë, me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës bujqësore, mbështetjes së fermerëve dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Operatori ekonomik ka realizuar me sukses punimet për montimin e serave të listës pritëse, duke përfunduar të gjitha sipas planit teknike të parapara në kontratë. Ky projekt ka për qëllim mbështetjen e fermerëve lokalë me infrastrukturë moderne bujqësore dhe nxitjen e prodhimit vendor.

Gjatë muajit shtator ka vazhduar bashkëpunimi i ngushtë me organizatën Qatar Charity, me të cilën kemi në proces disa projekte të rëndësishme:

Projekti i serave, për të cilin janë zhvilluar vizitt në terren dhe janë në zbatim aktivitetet përgatitore për përfituesit.

Projekti për motokultivatorë, për të cilin aktualisht jemi në fazën përgatitore dhe në pritje për vizita në terren.

Po ashtu, është duke u zhvilluar edhe projekti për zgjerimin e ujësjellësit në fshatin Krojmir, që do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët e këtij fshati dhe në zhvillimin e qëndrueshëm rural.

Komisioni Komunal për Bujqësi ka vazhduar punën intensive në verifikimin e dokumentacionit të aplikuesve për subvencionimin e fermerëve me freza, spërkatëse dhe shpërndarëse plehu mineral. Është duke vazdhaur verifikimi i dokumentacionit për të siguruar që përfituesit të jenë fermerët aktivë dhe më të përshtatshëm për mbështetje.

Operatori përgjegjës për trajtimin e qenve endacakë ka vazhduar punën sipas kërkesave të qytetarëve në disa lagje të Komunës së Lipjanit. Aktivitetet janë përqendruar në kapjen, trajtimin dhe sistemimin e qenve në mënyrë humane, duke kontribuar në përmirësimin e sigurisë publike dhe higjienës në hapësirat e Qytetit, lagëve dhe fshatrave.

Në bashkëpunim me organizatën IADK, gjatë muajit shtator janë përfunduar disa projekte që kanë pasur në fokus përkrahjen e grave ndërmarrëse, kryesisht në sektorin e pastëqerisë. Përmes këtij bashkëpunimi, një numër i konsiderueshëm i grave në Komunën e Lipjanit kanë përfituar pajisje dhe trajnim profesional, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik lokal dhe fuqizimin e rolit të gruas në biznes.

Gjatë muajit shtator është punuar edhe në trajtim dhe verifikim të kërkesave të qytetarëve në terren, sidomos për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore. Ekipet përkatëse kanë dalë në vendngjarje për evidentimin e dëmeve dhe përgatitjen e raporteve të nevojshme për kompensim ose ndërhyrje të mundshme.